



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA DHE MENAXHIMI ME FINANCAT NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

Projekti

“Vëzhgimi i parimeve të administratës publike në ruajtjen e vlerave të qeverisjes së mirë”



Projekti është mbështetur
nga Bashkimi Evropian



ЦЕНТАР ЗА
УПРАВУВАЊЕ СО
ПРОМЕНИ



Management Consulting Association





Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e "Qendrës për menaxhim me ndryshime" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA DHE MENAXHIMI ME FINANCAT NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

Projekti

“Vëzhgimi i parimeve të administratës publike në ruajtjen
e vlerave të qeverisjes së mirë”



**Botues:**

Qendra për menaxhim me ndryshime, Asociacioni për menaxhment konsulencë MKA-2000, Qendra për gazetari hulumtuese SKUP

Për botuesin:

Neda Maleska-Saçmaroska, Qendra për menaxhim me ndryshime

Autorë:

Martin Todevski, Ivana Qiurkçieva

Bashkëpunëtorë:

Shoqata Lëvizja për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik Global Manastir, Shoqata Qendra për iniciativa qytetare Prilep, Shoqata Federalistët e ri evropian – Maqedoni (XHEF Maqedoni), Shoqata multietnike dhe joqeveritare “Linda” Kumanovë, Shoqata NOVUS Strumicë, SHQ Shoqata ekologjike Planetum – Strumicë, Qendra e komunitetit e Komunës së Strugës, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë – Dibër, Shoqata e qytetarëve Qendra për edukim dhe zhvillim Tearcë, Shoqata Drita AGV Gostivar, Shoqata Hap drejt Evropës – Kavadar, Aradhja e skautëve “Dimitar Vllahov” Veles, Shoqata “Iniciativa e intelektualëve të papunësuar” Vinicë, Eho Organizatë edukative-humanitare – Shtip.

Përkthimi dhe lektura:

Vision Akademi

Dizajni dhe shtypi:

Poliesterdej

Tirazh:

200 ekzemplarë (tirazh pa pagesë/jo komercial)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

352:336.14(047.31)

TODEVSKI, Martin

Transparenca dhe llogarldhënia dhe menaxhimi me financat në njësitë e vetëqeverisjes lokale / [autorë Martin Todevski, Ivana Qurkçieva]. - Shkup : Qendra për menaxhim me ndryshime, 2018. - 39 стр. : илустр. ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамки на проектот: “Vëzhgimi i parimeve të administratës publike në ruajtjen e vlerave të qeverisjes së mirë

ISBN 978-608-4818-46-5

1. Qurkçieva, Ivana [автор]

а) Локална самоуправа - Управување со финансии - Транспарентност - Извештаи COBISS.MK-ID 109082634

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
2. Metodologjia e hulumtimit	7
I. Transparenca dhe llogaridhënia	9
1. Korniza juridike	11
2. Rezultatet	13
<i>2.1. Vija e llogaridhënies të pushtetit lokal</i>	<i>13</i>
<i>2.2. Aplikimi i mekanizmit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik</i>	<i>14</i>
<i>2.3. Vëzhgimi i rekomandimeve nga Enti shtetëror për auditim dhe Avokati i Popullit</i>	<i>14</i>
<i>2.4. Ueb transparenca e komunave</i>	<i>15</i>
<i>2.5. Ueb-qasje për personat me aftësi të kufizuara</i>	<i>18</i>
3. Rekomandime për transparencë dhe llogaridhënie	20
II. MENAXHIMI ME FINANCAT KOMUNALE	23
1. Vendosja teorike	25
2. Rezultatet	27
<i>2.1. Përgatitja e buxhetit</i>	<i>27</i>
<i>2.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit</i>	<i>27</i>
<i>2.3. Raportet financiare</i>	<i>29</i>
<i>2.4. Furnizimet publike</i>	<i>30</i>
<i>2.5. Kapacitetet për menaxhim financiar</i>	<i>31</i>
<i>2.6. Borxhi publik i komunave</i>	<i>31</i>
3. Rekomandime për menaxhim me financat komunale	33
<i>SHTOJCA 1 – Organizatat partnere - rigrantistë</i>	<i>34</i>
<i>SHTOJCA 2 – Lista e komunave të cilat u janë përgjigjur kërkesës për qasje të lirë deri te infomatat me karakter publik</i>	<i>35</i>
<i>SHTOJCA 3 – Lista e indikatorëve për ueb transparencë</i>	<i>36</i>
<i>SHTOJCA 4 – Lista e renditjes së komunave sipas barometrit për ueb transparencë</i>	<i>38</i>



1. Hyrje

Ky dokument është raporti i tretë¹ nga vëzhgimi i njësisve të vetëqeverisjes lokale në kuadër të projektit "Vëzhgimi i parimeve të administratës publike në ruajtjen e vlerave të qeverisjes së mirë", të financuar nga Bashkimi Evropian.

Projekti ka për qëllim të zhvillojë standarde për udhëheqje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në frymën e "Parimeve të administratës publike"² të përpiluara nga SIGMA³. Gjatë kësaj, praktikisht është bërë përshtatja e përcaktuesve të vendosur nga SIGMA, në kontekst të punës së vetëqeverisjeve lokale.

Standardet e përpiluara për udhëheqje të mirë⁴ përdoren nga 14 organizata qytetare (Lista e organizatave është dhënë në Shtojcën 1 të raportit) si kornizë për vëzhgimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale në fushat: zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive, menaxhimi me burimet njerëzore, praktikimi i transparencës dhe llogaridhënies, sigurimi i shërbimeve dhe menaxhimi me financat komunale.

Raporti fokusohet në shkallën e praktikimit të transparencës dhe llogaridhënies nga ana e njësisve të vetëqeverisjes lokale, si dhe menaxhimi me financat. Raporti bazohet në vëzhgimin e vetëqeverisjes lokale në periudhën prej qershorit deri në tetor të vitit 2018. Të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet e përpunuara kanë të bëjnë me të gjitha tetë rajonet në vend: verilindor, lindor, jugperëndimor, juglindor, i Pellagonisë, i Pollogut, i Vardarit dhe i Shkupit.

1 Raportet paraprake të përpunuara në kuadër të projektit janë: Sigurimi i shërbimeve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, Qendra për menaxhim me ndryshime, 2018; Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe strategjive dhe menaxhimi me burimet njerëzore në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Qendra për menaxhim me ndryshime, 2018

2 Parimet e administratës publike, SIGMA, 2017
(http://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration_Edition-2017_ENG.pdf)

3 SIGMA është iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, qëllimi i të cilit është fuqizimi i udhëheqjes së mirë në sektorin publik.

4 Standardet për udhëheqje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Qendra për menaxhim me ndryshime, 2017

2. Metodologjia e hulumtimit

Raporti është përgatitur në bazë të hulumtimit të realizuar përmes:

- Qasjes së lirë deri te informatat me karakter publik
- Analiza e ueb faqeve të komunave

Përmes **kërkesave për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik** u kërkuan informatat që vijojnë:

- Për fushën e transparencës dhe llogaridhënies: numri i ndërmarrjeve dhe institucioneve publike të themeluara nga komunat dhe raportet financiare të marra nga ato, numri i kërkesave të pranuar për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik dhe veprimi sipas tyre, auditimet e kryera nga Enti shtetëror për auditim dhe veprimi sipas rekomandimeve, veprimi sipas rekomandimeve të fituara nga raporti i Avokatit të Popullit etj.
- Për fushën e menaxhimit me financat komunale: buxheti, llogaria përfundimtare, plani për furnizime publike, raportet financiare tremujore, numri i ditëve për komentim dhe shqyrtimi i Propozim buxhetit, numri i marrëveshjeve të lidhura për furnizime publike në bazë të procedurave të ndryshme për furnizime publike, anekset e lidhura për ndryshimin e vlerave të marrëveshjeve, shpalljet e publikuara për furnizime publike dhe numri i ofertave të fituara, numri i aukcioneve të zbatuara elektronike, ekipimi i njësive organizative për menaxhim financiar, të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara në buxhet sipas kategorive të ndryshme etj.

U krye **analiza e ueb faqeve të komunave** me qëllim që të vërtetohet shkalla e ueb transparencës, gjegjësisht shkalla e plotësimit të indikatorëve nga standardet e përpiluara për e-transparencë të Qendrës për menaxhim me ndryshime⁵.

Po ashtu, u krye edhe **analiza cilësore** e buxheteve dhe llogarive përfundimtare të marra nga komunat me qëllim të vërtetimit të dhënave të fituara përmes kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

5 Standardet për e-transparencë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Qendra për menaxhim me ndryshime, 2017



I. Transparenca dhe llogaridhënia



1. Korniza juridike

Një nga parimet kryesore të udhëheqjes së mirë të njërive të vetëqeverisjes lokale (komunat) është transparenca dhe llogaridhënia në punë. Qytetarët duhet të informohen për punën e komunave, si kusht për nxitjen e pjesëmarrjes në krijimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal.

Obligimi për transparencën dhe llogaridhënien e komunave, por edhe nga nevojat në rritje të qytetarëve për informata për fusha të ndryshme nga puna e komunave.

Lidhur me kornizën juridike:

• **Kushtetuta e RM** përcakton që:

- Qytetarët e Republikës së Maqedonisë pushtetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë (Neni 2).
- Garantohet qasja e lirë tek informatat, liria e pranimit dhe e bartjes së informatave (Neni 16).
- Çdo qytetar ka të drejtë të parashtrijë parashtrësia në organet shtetërore dhe shërbimet e tjera publike dhe për ato të marrë përgjigje (Neni 24).
- Në njësitë e vet administrimit lokal qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale (Amendamenti XVII) (Neni 115).

• **Ligji për vetëqeverisjen lokale** (në nenin 8) përcakton se organet e komunës (kryetari dhe këshilli), komisionet e këshillit dhe veprimtaritë publike të themeluara nga komuna, janë të obliguara pa kompensim t'i informojnë qytetarët për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë me rëndësi për zhvillimin e komunës, në mënyrë të përcaktuar me statutin; si dhe se komuna është e obliguar qytetarëve t'iu mundësojë qasje në informatat themelore për shërbimet që ua siguron, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me statutin.

• **Ligji për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik** i përcakton obligimet e pronarit të informatave në raport me informimin për:

- të dhënat themelore për kontakt me pronarin e informatës, emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresa e e-postës dhe adresa e ueb faqes;
- mënyra e parashtrimit të kërkesës për qasje deri te informatat;
- si mënyrë e informimit të opinionit për punën e vet, pronari i informatave nevojitet t'i publikojë aktet ligjore dhe nënligjore në ueb faqen zyrtare të institucionit; të publikojnë kumtesa deri te opinionit për punët e ndërmarra nga ana e tyre në pëlqim me kompetencat ligjore; të publikojnë të dhëna statistikore për punën e vet; t'i publikojnë raportet për punën të cilat parashtrihen deri te organet kompetente për zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe në mënyrë tjetër të paraparë me ligj, që t'i bëjnë të kapshme të gjitha informatat me karakter publik; t'i publikojnë propozim programet, programet, strategjitë, qëndrimet, mendimet, studimet dhe dokumentet tjera të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me kompetencat e pronarit të informatave; t'i publikojnë të gjitha thirrjet në procedurën për furnizime publike dhe dokumentacionin e tenderit, të publikojnë edhe informata tjera të cilat dalin nga kompetencat dhe puna e tyre.
- Më shumë **ligje materiale** të ndara të cilat e përcaktojnë obligimin e komunave për udhëheqjen e regjistrave ose evidencave të informatave/të dhënave në fusha të ndryshme të punës. Për shembull: Ligji për tatimet e pronës parashih që komunat të udhëheqin regjistër të pronës së



patundshme dhe të tundshme; Ligji për ambientin jetësor parasheh që komunat të udhëheqin kadastër për ambientin jetësor, kadastër i krijuesve të zhurmës në ambientin jetësor, regjistër të B-lejeve ekologjike të integruara etj.; Ligji për mbrojtje të fëmijëve parasheh që komunat të udhëheqin regjistër të institucioneve publike për fëmijët të themeluara nga komunat etj.

- **Ligji për përdorimin e të dhënave nga sektori publik** i përcakton obligimet e komunave për shpalljen publike të dhënave (në format të përpunuar me kompjuter) të cilat i krijojnë në realizimin e kompetencave të veta në pëlqim me ligjin, me qëllim të mundësojnë (pa pagesë dhe lirë) përdorimin e këtyre të dhënave nga ana e personave juridik ose fizik për krijimin e informatave, përmbajtjeve, aplikimeve ose shërbimeve të reja.

Mënyra e sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies në punën e komunës, përmes informimit të rregullt të opinionit, shfrytëzimit e të drejtës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, mbledhjet e hapura të komunës, prezenca në mbledhje, pjesëmarrje në vendimmarrje përmes organizimit të referendumit, iniciativë qytetare, tubim i qytetarëve ose përmes shfrytëzimit të drejtës për parashtrimin e parashtesave, më hollësisht është rregulluar në aktin më të lartë juridik – Statutin e komunës. Për shkak të definimit më të hollësishëm të standardeve për transparencë dhe mënyrën e sigurimit dhe praktikimit të tyre, nevojitet që komuna të ketë edhe akt të brendshëm (rregullore), si dhe procedurën që e përcakton procesin e punës së shërbimeve kompetente, konkretisht bartësve të përgjegjësive konkrete. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të sigurohen edhe kushtet për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, përmes definimit të procesit të konsultimit dhe mënyrës se si do të zbatohet, me hapa të saktë të caktuar dhe kornizë kohore. Kjo do të thotë informim me kohë e opinionit për çështjen e cila do të ishte lëndë e konsultimit, informimi i grupeve të prekura qëllimore në mënyrë të paraparë, sigurimi i mënyrës inkluzive e shprehjes së mendimit të opinionit, analiza e rezultateve nga procesi konsultativ në kuptim se cilat propozime janë pranuar e cilat jo, me arsyetimin pse nuk janë pranuar.

Qëllimi është të rregullohet qarkullimi i informatave në suaza të komunës (informim i brendshëm), qarkullimi i informatave nga komunat drejt opinionit (informim i jashtëm), si dhe të drejtat dhe obligimet e organeve të komunës dhe administratës komunale në realizimin e publikes në punë.

2. Rezultatet

2.1. Vija e llogaridhënies të pushtetit lokal


Komunat themelojnë ndërmarrje dhe institucione publike përmes të cilave sigurojnë shërbime të caktuara publike në dobi të qytetarëve, gjegjësisht kryejnë veprimtari me interes publik.

Nga të dhënat e fituara prej 59 komunave⁶, mund të konstatohet se komunat mesatarisht themelojnë nga 5 ndërmarrje dhe institucione publike. Gjithsesi, numri i ndërmarrjeve dhe institucioneve publike të cilat themelohen varet nga madhësia e komunës, gjegjësisht në përgjithësi komunat më të mëdha themelojnë më tepër ndërmarrje dhe institucione publike.

Në grafikun që vijon është prezantuar përqindja e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike të cilat janë themeluar nga komunat urbane/rurale. Gjatë kësaj, komunat urbane kanë themeluar 75% të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, derisa komunat rurale kanë themeluar 25% të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike.

Grafiku 1

Ndërmarrjet dhe institucionet publike të themeluara nga komunat urbane dhe rurale



Në pajtim me nenin 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike, ndërmarrja publike e ka për obligim të parashtrijë raporte tremujore deri te themeluesi, të cilat do të përmbajnë tregues penën financiare. Raportet financiare mes organeve të komunës dhe organeve të Qytetit të Shkupit, dhe ndërmarrjeve publike duhet të jenë transparente⁷.

Sipas të dhënave të fituara, ekziston shkallë shumë e lartë e plotësimit të obligimit të parashtrimit të raporteve të rregullta financiare nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike deri te themeluesit

⁶ Komunat të cilat iu janë përgjigjur kërkesës për qasje të lirë deri te komunat të cilat i janë përgjigjur kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik janë prezantuar në shtojcën 2.

⁷ Neni 8-b nga Ligji për ndërmarrjet publike




e tyre - komunat. Në të vërtetë, 96% të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike kanë dorëzuar raporte të rregullta financiare për vitin 2017. Megjithatë, siç është prezantuar më poshtë, një përqindje e vogël nga komunat i kanë publikuar këto raporte financiare.

2.2. Aplikimi i mekanizmit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik

Mesatarisht komunat kanë pranuar 25 kërkesa për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik në vitin 2017. Komunat të cilat kanë pranuar më së shumti kërkesa janë prezantuar në grafikun 2.

Grafiku 2

Komunat të cilat kanë pranuar më së shumti kërkesa për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik në vitin 2017



Përqindja e kërkesave të pa përgjigjur ose të refuzuara për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik është mjaft e ulët: Komunat gjithsej nuk u janë përgjigjur 2%, ndërsa i kanë refuzuar 1% të kërkesave të pranuar për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.


Në suaza të hulumtimit u bë përpjekje për konfirmimin e këtyre të dhënave, si dhe të dhënat rreth asaj se sa është praktikuar e drejta e ankesës. Për këtë qëllim, u kërkua informata nga Komisioni për mbrojtje të drejtës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik për numrin e ankesave të parashtruara dhe të pranuara lidhur me kërkesat për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik të drejtuara deri te komunat, por dy herë kërkesa u refuzua me arsyetimin se akoma nuk janë caktuar emëruar anëtarët e Komisionit.

2.3. Vëzhgimi i rekomandimeve nga Enti shtetëror për auditim dhe Avokati i Popullit

Në 4 vitet e fundit, Enti shtetëror për auditim mesatarisht ka kryer nga 1 auditim për komunë. Por, nga të dhënat e fituara prej 56 komunave, në 31 komuna (55%) nuk është kryer auditim nga ana e Entit shtetëror për auditim gjatë 4 viteve të fundit.

Grafiku 3

Komunat ku është kryer auditimi nga Enti shtetëror për auditim gjatë 4 viteve të fundit



Komunat në mënyrë deklarative theksojnë se në mënyrë konsekuente i kanë zbatuar rekomandimet e dhëna nga Enti shtetëror për auditim në raportin e fundit për komunën: bile 80% të rekomandimeve të dhëna nga raporti i fundit janë zbatuar. Megjithatë, shpeshherë rekomandimet e Entit shtetëror për auditim përsëriten.

Vetëm komunat Pehçevë, Rankovc dhe Nagoriçan i Vjetër kanë deklaruar se në raportin e fundit të Avokatit të Popullit janë dhënë rekomandime të cilat kanë të bëjnë me këto komuna. Komunat Rakonvc dhe Nagoriçan i Vjetër i kanë zbatuar rekomandimet e dhëna, ndërsa Pehçeva jo.

2.4. Ueb transparencja e komunave

Qytetarët më shumë e përdorin internetin si mënyrë për informim, duke përfshirë edhe informimin për punën e institucioneve shtetërore. Publikimi i informatave nga komunat në ueb faqet e tyre mundëson qasje më të lehtë deri te informatat për funksionimin e komunave në suaza të këtyre kompetencave, por edhe thjeshtimin e komunikimit me qytetarët në drejtim të përmbushjes së të drejtave dhe obligimeve të tyre.

Standardet për udhëheqje të mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në pjesën e transparencës dhe llogaridhënies, parashohin një indikator kompozitë për ueb transparencën të përbërë nga indikatorë individual për 78 tipa të ndryshëm të informatës, të cilët duhet të publikohen në ueb faqet e komunave. Kjo listë e informatave është fituar si rezultat i obligimeve ligjore të komunave të publikojnë informata me karakter publik ose informata lidhur me kompetencat e tyre, obligimet ligjore të definuar në ligje të caktuara materiale për udhëheqjen e regjistrave të caktuar / evidenca të dhënave, si dhe në pajtim me nevojat e theksuara të qytetarëve për informata të caktuara plotësuese⁸.

Janë analizuar ueb faqet e të gjitha komunave në vend me qëllim që të konstatohet niveli i plotësimi të indikatorëve për ueb transparencë, gjegjësisht shkalla e publikimit të informatave të nevojshme në ueb faqet⁹.

Gjatë kësaj, për çdo komunë është analizuar nëse informatat e definuara janë publikuar dhe jepet vlerësimi mesatar – indeksi i ueb transparencës në nivel të komunës. Nëse merren parasysh vlerësimet e të gjitha komunave mund të ndërtohet barometër i ueb transparencës për të gjitha komunat.


⁸ Lista e informatave është vërtetuar në suaza të hulumtimit të Qendrës për menaxhim me ndryshime, gjegjësisht nga "Standardet për e-transparencë të njëjësive të vetëqeverisjes lokale", si pjesë e projektit "Qyteti në vend të parë", i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i realizuar në periudhën 2016-2017.

⁹ Lista e indikatorëve për ueb-transparencë sipas të cilave është realizuar hulumtimi është prezantuar në Shtojcën 3.




Gjatë kësaj analize, barometri i ueb transparencës së komunave është konstatuar në nivel mesatar prej **20,47%** (grafiku 4).

Grafiku 4
Indeksi i ueb transparencës së komunave



Indeks më të lartë të ueb transparencës ka komuna e Shtipit (61,54%), derisa më të ulët komuna e Zelenikovës (1,28%). Në periudhën e analizës, komunat Bogovinë, Bërvenicë, Vrapçisht, Rankovc, Nagoriçan i Vjetër dhe Butel nuk kanë pasur ueb faqe, ose në atë periudhë nuk ka funksionuar, dhe prandaj për ato indeksi është prezantuar me 0%.¹⁰








Grafiku 5
Lista e 5 komunave me indeks më të lartë të ueb transparencës



Hulumtimi tregoi se më së shumti publikohet llogaria përfundimtare (75%) nga fusha e financave, derisa më së paku informata lidhur me mjedisin jetësor në komunë.

Në vazhdim është prezantuar përqindja e informatave të publikuara në ueb faqet e komunave për indikatorë të caktuar sipas fushave.

¹⁰ Lista e renditjes së komunave sipas barometrit të ueb transparencës është prezantuar në Shtojcën 4.

	<p>Puna financiare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Llogaria përfundimtare 76% • Buxheti 74% • Plani për furnizime publike 34% • Raportet tremujore dhe vjetore financiare 24% • Raportet financiare të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike të themeluara nga komunat 20% • Raport nga Enti shtetëror për auditim 16% • Raportet programore financiare 8% • Raport për realizimin e furnizimeve publike 4%
	<p>Puna e Këshillit dhe administratës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Buletine zyrtarë 63% • Statuti i komunës 59% • Informata për anëtarët e Këshillit 44% (duke përfshirë kontaktet) • Organizimi dhe kontakte të administratës 41%
	<p>Shërbimet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formularët 39% • Lista e shërbimeve të cilat sigurohen 27% • Udhëzime 20%
	<p>Zhvillimi ekonomik lokal</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjia / Programi për zhvillim ekonomik lokal 32% • Lista e veprimtarive turistike me vëllim të vogël 13% • Lista e veprimtarive hotelerie me vëllim të vogël 12% • Lista e veprimtarive tregtare me vëllim të vogël 9% • Struktura e fuqisë së punës në komunë 5%
	<p>Kulturë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objekte nga fusha e kulturës në territorin e komunës 33% • Monumente përkujtimore në territorin e komunës 31% • Strategjia / Programi për kulturë 19%
	<p>Arsimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkollat fillore në territorin e komunës 60% • Shkollat e mesme në territorin e komunës 45% • Strategjia / Programi për arsim 15%
	<p>Sport</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objekte sportive në territorin e komunës 27%




	<p>Urbanizëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planet e miratuara urbanistike 31% • Propozim – planet urbanistike 16% • Raport vjetor për lejet e miratuara për ndërtim 3% • Objekte me certifikatë për karakteristika energjetike 0%
	<p>Çerdhe për fëmijë / Shtëpi për pleq</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çerdhe për fëmijë në territorin e komunës 36% • Shtëpi për pleq në territorin e komunës 1%
	<p>Projekte të komunës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekte të komunës (të realizuara edhe në fazën e realizimit) 29%
	<p>Ambienti jetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leje të integruara ekologjike – B të lëshuara 16% • Substanca ndotëse 3% • Kadastër i ambientit jetësor 3% • Kadastër i krijuesve të mbeturinave 1%

On-lajn vegla për komunikim / konsultimi me qytetarët është mundësuar nga 20% të komunave. Kjo më shpesh ka të bëjë me veglën për paraqitjen e problemit, që si aplikacion i vetëm ishte siguruar për komunat.

Asnjë komunë nuk publikon set të dhënash të strukturuar në formë të dhënave të hapura.

2.5. Ueb-qasja për personat me aftësi të kufizuara



-Krahas sigurimit të qasjes fizike deri te objektet e komunës për personat me aftësi të kufizuara (p.sh. përmes vendosjes së rampës, ashensorëve etj.), duhet t'i kushtohet vëmendje edhe sigurimit dhe qasjes elektronike për këtë kategori të qytetarëve. Në të vërtetë, personat me tip të caktuar të aftësisë së kufizuar, shfrytëzojnë pajisje të ndryshme me teknologji asistive të cilat u ndihmojnë në qasjen deri te përmbajtjet e kompjuterit. Për shembull, personat e verbër dhe personat me shikim të dëmtuar, përdorin lexues të ekranit të cilët automatikisht i shndërrojnë përmbajtjet tekstuale në audio të folur.

Që të mundësohet qasje më e lehtë e pajisjeve dhe sistemeve me teknologji asistive deri te përmbajtjet në internet, ueb faqet duhet të përpunohen në atë mënyrë që do të mundësojnë njohjen e përmbajtjeve të publikuara (a është fjala për titull, pasus, link, fotografi për të cilën është dhënë tekst

alternativ etj.). Nga ana tjetër, nevojitet të ndiqen rregullat e caktuara në prezantimin e përmbajtjeve: për shembull, nuk duhet të shfaqen përmbajtje që ndriçojnë, pasi që kjo paraqet problem te personat me epilepsi fotosensitive.

Këto standarde ndërkombëtare në përpunimin e ueb faqeve janë përfshirë në udhëzues për ueb qasje, të përpiluar nga WZS konzorciumi, në suaza të iniciativës për ueb qasje.¹¹

Ueb faqet e të gjitha komunave (të cilat kanë ueb faqe) janë testuar për shkallën e përmbushjes së udhëzuesit/rregullat për ueb qasje¹². Vegla për testim automatik tregoi mesatarisht 24 gabime për një ueb faqe. Kjo do të thotë se komunat nuk u kushtojnë vëmendje ueb qasjes gjatë përpunimit dhe mirëmbajtjes së ueb faqeve.

11 Versioni aktual i udhëzuesit për ueb qasjen WCAG (Web Content Accessibility Guidelines) është 2.1. Udhëzuesi është publikuar në linkun që vijon (<https://www.w3.org/WAI/standards-guidelines/wcag/>).

12 Testimi është kryer përmes veglës WAVE (web accessibility evaluation tool), që gjendet në linkun që vijon: <http://wave.webaim.org/>. U analizua faqja fillestare e ueb faqeve të komunave.



3. Rekomandime për transparencë dhe llogaridhënie

- ▶ Komunat të publikojnë informata më të hollësishme për ndërmarrjet dhe institucionet publike të themeluara prej tyre, duke përfshirë përshkrimin e veprimtarisë, shërbimet të cilat ofrohen, çmimet e shërbimeve (nëse janë relevante) etj.
- ▶ Të publikohen raporte financiare të cilat ndërmarrjet dhe institucionet publike i dorëzojnë për shqyrtim te Këshilli i komunës.
- ▶ Të publikohen kërkesat e pranuar për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik dhe përgjigjet e dhëna nga komunat. Në këtë mënyrë do të ulet numri i kërkesave të ardhshme, e me këtë do të zvogëlohet edhe ngarkimi i administratës komunale që t'i procedojë të dhënat dhe informatat e kërkuara.
- ▶ Të publikohen raportet nga auditimet e kryera të Entit shtetëror për auditim dhe të publikohet raporti rreth asaj se si ka vepruar komuna sipas rekomandimeve dhe vërejtjeve të Entit shtetëror për auditim.
- ▶ Të mos përdoren ueb faqet vetëm si vegje promovuese të kryetarëve të komunave, por të publikohen informata të cilat me të vërtetë u nevojiten qytetarëve.
- ▶ Transparenca financiare si kusht themelor për sigurimin e llogaridhënies në punën e komunave do të thotë publikim i spektrit më të gjerë të informatave nga kompetencat e komunës, duke përfshirë raportet tremujore dhe vjetore financiare, si dhe informata për punën e kryetarit të komunës dhe të këshillit, të administratës, shërbimet të cilat sigurohen, informata nga fusha e urbanizimit, zhvillimit ekonomik lokal, kulturës, arsimit, sportit, mjedisit jetësor, mbrojtjes sociale, projekte aktuale të komunës me konstruksion financiar dhe burimet e mjeteve etj.
- ▶ Të publikohen sete të dhënash të strukturuar në formë të dhënave të hapura për shkak të avancimit të transparencës, shfrytëzimit të potencialit ekonomik dhe përmirësimit të shërbimeve të komunave.
- ▶ Të vëzhgohen standardet për e-transparencë për shkak të publikimit të unifikuar të informatave dhe të dhënave nga ana e komunave.
- ▶ Të përdoret një formular për ueb faqen për shkak të unifikimit të dukjes dhe strukturës së ueb faqeve të gjitha komunave, e me këtë edhe thjeshtimi i kërimit të informatave nga ana e qytetarëve¹³.

¹³ Në kuadër të projektit "Qytetari në vend të parë", i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i zbatuar nga Qendra për menaxhim me ndryshime dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Alka, u përpilua formular i unifikuar i ueb faqes për komunat. Në të njëjtin mund të qaset nga <http://web.opstina.mk>.

- ▶ Të ofrohen on-line vegla për komunikim të qytetarëve me kryetarin e komunës, këshilltarët dhe administratën e komunës.
- ▶ Të vëzhgohet udhëzuesi ndërkombëtar për ueb qasje WCAG me qëllim që të mundësohet qasje më e lehtë deri te ueb faqet e komunave për personat me aftësi të kufizuara.



II. MENAXHIMI ME FINANCAT KOMUNALE



1. Vendosja teorike

Korniza ligjore e cila e rregullon menaxhmentin publik financiar në nivel lokal është paraqitur përmes ligjeve që vijojnë:

- ▶ **Ligji për buxhetet** ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 64/2005, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16) me të cilin sigurohet korniza e hollësishme për procesin buxhetor, gjegjësisht me këtë ligj rregullohen procedura për përpilimin, miratimin, menaxhimi dhe ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe të buxheteve të njërive të vetëqeverisjes lokale (komunat) dhe Qytetit të Shkupit.
- ▶ **Ligji për ekzekutimin e buxheteve të R. Maqedonisë** sipas të cilit shpërndahen mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për shfrytëzuesit buxhetor dhe njësitë shfrytëzuese. Me interes për komunat është shpërndarja e mjeteve për bllok dotacione dhe me dedikim në llogari të komunave në bazë të vendimeve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ndërsa për financim të kompetencave të transferuara, në dinamikë të harmonizuar me Ministrinë e Financave.
- ▶ **Ligji për vetëqeverisje lokale** ("Gazeta zyrtare e RM" nr.5 nga data 29.01.2002) me të cilin rregullohen: kompetencat e komunës; pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në vendimmarrje; organizimi dhe puna e organeve të komunës; administrata komunale; aktet e organeve; prona - pronë e komunës; mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës; shpërbërja e këshillit të komunës; mekanizmat e bashkëpunimit mes komunave dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë; vetëqeverisja vendore; mbrojtja e vetëqeverisjes lokale; vërtetimi i gjuhëve zyrtare në komuna dhe çështje tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.
- ▶ **Ligji për financim të njërive të vetëqeverisjes lokale** ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/11 dhe 192/15) me të cilin rregullohet financimi i komunave, me saktë: caktimi dhe pagesa e të hyrave të komunave, marrja e borxhit nga komunat, buxheti i komunave - përmbajtja, miratimi, menaxhimi, raportimi, evidenca e kontabilitetit, kontrolli dhe auditimi.
- ▶ **Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar** ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 90/2009, 12/11, 188/13 dhe 192/15) me të cilin rregullohet sistemi i kontrollit të brendshëm publik financiar në Republikën e Maqedonisë (menaxhimi dhe kontrolli financiar, auditimi i brendshëm dhe harmonizimi i tyre).
- ▶ **Ligji për kontabilitet për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetor** ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 61/2002, 98/2002, 82/2005, 24/11, 145/15 dhe 170/17) me të cilin rregullohet udhëheqja e kontabilitetit, librat afarist, dokumentet e kontabilitetit dhe përpunimi i të dhënave, njohja e të hyrave dhe shpenzimeve, vlerësimi i pozitave të bilancit, revalorizimi, raportet financiare, dorëzimi i raporteve financiare dhe çështje tjera lidhur me kontabilitetin e buxheteve të shfrytëzuesve buxhetor, mes të cilëve edhe të buxheteve të komunave.

Buxheti, e paraqet kornizën kryesore financiare të komunës, e cila përbëhet prej pjesës së përgjithshme, të veçantë dhe zhvillimore. Pjesa e përgjithshme përfshinë: bilancin e konsoliduar të



hyrave dhe shpenzimeve, klasifikimin funksional të shpenzimeve, bilancin e të hyrave dhe shpenzimeve aktuale-operative, dhe bilancin e të hyrave dhe shpenzimeve kapitale. Në pjesën e veçantë të buxhetit janë shfaqur shpenzimet sipas klasifikimit të shpenzimeve që e rregullon ministri i Financave, të grupuara sipas shfrytëzuesve dhe programeve.

Buxheti participativ supozon se qytetarët janë të përfshirë në procesin e përpilimit të buxhetit dhe planifikimin financiar. Me këtë, qytetarët mund të inkuadrohen në pjesën më të rëndësishme të përgatitjes së politikave në nivel lokal.

Procesi buxhetor fillon me përpilimin e cirkularit buxhetor për vitin e ardhshëm nga ana e ministrit të Financave, ku komunat informohen për indikatorët themelor makro-ekonomik, drejtimet kryesore për përpilimin e buxhetit komunal, shtesat për komunat që do të transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë nga buxhetet e fondeve, si dhe nga të hyrat nga burimet tjera. Mbi bazë të kësaj përpilohet buxheti i komunës, që e miraton Këshilli i komunës.

Shfrytëzuesit buxhetor komunal deri te kryetari i komunës dorëzojnë **raporte financiare** mujore me arsyetim për ekzekutimin e planeve të tyre financiare. Kryetari i komunës parashton raporte financiare tremujore deri te Këshilli komunal dhe Ministria e Financave, me arsyetim për ekzekutimin e buxhetit.

Pas skadimit të vitit fiskal, Këshilli komunal e miraton **llogarinë përfundimtare** të buxhetit komunal, e cila i përmban të gjitha elementet që i përmban buxheti i komunës të shprehura në të hyra dhe shpenzime të planifikuara dhe të realizuara për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor komunal. Pas miratimit të llogarisë vjetore kryetari i komunës e informon opinionin për përmbajtjen e saj.

Furnizimet publike të komunës realizohen përmes sistemit të vetëm të centralizuar elektronik për furnizime publike (SCFP), përmes të cilit në tërësi realizohen të gjitha furnizimet publike përmes formës elektronike.

2. Rezultatet


2.1. Përgatitja e buxhetit

Procesi i përgatitjes së buxhetit duhet të jetë përfshirës, gjegjësisht të sigurojë hapësirë të mjaftueshme dhe kohë për prezantim të buxhetit të planifikuar dhe marrjen e vërejtjeve për të njëjtin nga palët e interesuara.

Në mënyrë deklarative, në përgjigjet ndaj kërkesave për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, komunat kanë dhënë informatë se e kanë publikuar propozim buxhetin dhe se e kanë paraparë një kohë të mjaftueshme relative për rishikimin e tij dhe komentim nga ana e qytetarëve. Nga përgjigjet e fituara prej 52 komuna, propozim buxhetin për vitin 2018, qytetarët kanë pasur mundësi që ta marrin mesatarisht 13 ditë para ditës së miratimit.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që në afat optimal para miratimit të tij, propozim buxheti t'u dërgohet edhe këshilltarëve, që të kenë kohë të mjaftueshme për ta analizuar para se të miratohet. Nga përgjigjet e fituara prej 53 komuna, mesatarisht propozim buxhetin për vitin 2018, këshilltarët e kanë marrë 14 ditë para miratimit.

Grafiku 6
Qasja deri te propozim buxheti i komunave për vitin 2018



2.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit


Përmes realizimit të buxhetit realizohen kompetencat e komunave të rregulluara me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet tjera sektoriale.

Në përgjithësi komunat nuk kanë shkallë të mirë të realizimit të buxheteve. Sa për ilustrim, për vitin 2017 janë realizuar 63,75% të hyrave të planifikuara buxhetore, dhe 65,61% të shpenzimeve të planifikuara buxhetore (grafiku 7).



Gjatë kësaj, prej komunave të cilat kanë shkallë të lartë të realizimit të shpenzimeve buxhetore mund të veçohen: Komuna e Koçanës me 87,63%, Komuna e Zërnovcit me 84,53%, Komuna e Jegunovcit me 84,42%, Komuna e Qendrës Zhupë me 84,41, Komuna e Vinicës me 84,10%, Komuna e Strugës me 83,43%, Komuna e Dibrës me 82,30%, Komuna e Prilepit me 83,29%, Komuna e Rosomanit me 80,80%.


Grafiku 7
Realizimi i buxhetit për vitin 2017 nga komunat




Komunat më së shumti financohen nga burimet e veta dhe nga mjetet e buxhetit të Republikës së Maqedonisë përmes bllok dotacioneve të destinuar dhe kapitale. Komunat më së shumti bëjnë harxhime vijuese-operative. Harxhimet për rroga dhe subvencione janë mesatarisht 33,16%, derisa harxhimet kapitale janë 30,58% nga harxhimet e përgjithshme të buxhetit (grafikonet 8 dhe 9).

Harxhimet për mbështetje dhe bashkëpunim me sektorin qytetar janë minimale: 0,73% nga harxhimet e përgjithshme.

Grafiku 8
Burimet e të hyrave të buxhetit 2018



Grafiku 9
Harxhime sipas tarifave buxhetore në vitin 2018



2.3. Raportet financiare


Komuna e ka për obligim të parashtrijë raporte të rregullta financiare tremujore deri te Këshilli i komunës, me arsyetim për ekzekutimin e buxhetit, për shkak të rishikimit të tyre nga ana e këshilltarëve.

Komunat në mënyrë konsekuente e plotësojnë obligimin, duke parë faktin se për vitin 2017 të gjitha komunat kanë dorëzuar nga katër raporte financiare tremujore deri te Këshilli (përveç Komunës Kriva Pallankë e cila ka dorëzuar 2 dhe Komuna e Butelit e cila ka dorëzuar 3 raporte financiare tremujore).

Në të vërtetë, komunat e kanë për obligim që këto raporte financiare tremujore t'i dorëzojnë deri te Ministria e Financave. Këtë obligim e kanë përmbushur të gjitha komunat në tërësi, duke i dorëzuar të gjitha raportet financiare tremujore.

Megjithatë, më pak se gjysma e komunave raportet financiare tremujore i kanë publikuar në ueb faqet e tyre: 38,89% të komunave i kanë publikuar raportet financiare tremujore për vitin 2017.

Grafiku 10
Përqindja e raporteve tremujore financiare të dorëzuara dhe të publikuara





2.4. Furnizimet publike


Në vitin 2017 dhe 2018, mesatarisht janë lidhur nga 34 kontrata për furnizime publike për një komunë. Nga të dhënat e fituara prej 52 komuna, në vitin 2018 më së shumti kontrata për furnizime publike kanë lidhur komunat që vijojnë: Komuna e Velesit 109, Komuna e Karposhit 99, Komuna e Novacit 90 dhe Komuna e Kumanovës 77.

Numri i kontratave të lidhura për furnizime publike përmes procedurave të negocimit pa publikim të shpalljes publike në komuna është i vogël. Në vitin 2017,

Numri i procedurave për negocim pa publikim të shpalljes publike ka qenë 0,73% nga gjithsej kontratat e nënshkruara, ndërsa në vitin 2018 është 1,20% (grafiku 11). Më së shumti kontrata përmes procedurave të negocimit pa publikim të shpalljes publike në vitin 2018 ka lidhur Komuna e Karposhit (7).

Sipas të dhënave të fituara nga 51 komuna, vlera mesatare e kontratave të lidhura për furnizime në bazë të procedurës së zbatuar me negocim pa publikim të shpalljes publike në vitin 2017 ka qenë 478.692,00 denarë për një komunë, derisa në vitin 2018 ka qenë 1.085.881,00 denarë.

Grafiku 11




Mesatarisht, komunat në nivel vjetor kanë lidhur 1 aneks për rritjen e vlerës së kontratave fillestare për furnizime, ndërsa vlera e përgjithshme mesatare e rritur e kontratave fillestare për furnizime në vitin 2017 ka qenë 810.495,00 denarë, derisa në vitin 2018 është 802.920,00 denarë.

Në vitin 2017, nga të dhënat prej 51 komuna, mesatarisht çdo komunë ka publikuar nga 35 shpallje për furnizime publike, ndërsa në vitin 2018 nga 39. Numri mesatar i ofertave të fituara për një thirrje për furnizime publike në komunë, në të dy vitet ka qenë 3.


Nga procedurat e zbatuara për furnizime publike, në vitin 2017 83,77% prej tyre kanë përfunduar me aukcion elektronik, ndërsa në vitin 2018, 86,48% (grafiku 12).

Grafiku 12

Procedurat për furnizime publike të cilat kanë përfunduar me e-auksion në vitin 2017



Pocedurat për furnizime publike të cilat kanë përfunduar me e-auksion në vitin 2018



■ Me e-auksion

■ Pa e-auksion

2.5. Kapacitetet për menaxhim financiar

Në njësitë organizative kompetente për menaxhimin financiar në komuna, mesatarisht punojnë nga 6 të punësuar. Të punësuarit të cilët punojnë te furnizimet publike mesatarisht janë nga 2 për një komunë, ndërsa të punësuarit të cilët bëjnë auditim të brendshëm mesatarisht nga 1 i punësuar për komunë.

Përqindja e të punësuarve në njësitë organizative kompetente për menaxhimin financiar në komuna në raport me numrin e përgjithshëm të punësuarve është 12,43%.

2.6. Borxhi publik i komunave

Në pajtim me Ligjin për mbështetje financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe njësive shfrytëzuese të themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e borxheve të arrira, obligimeve të papaguara ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 209/18), borxhi i përgjithshëm i të gjitha komunave, në fund të muajit shtator 2018, kap vlerën 5.945.849.189,00 denarë, ose 96.680.475 euro.

Me ligjin sigurohet mbështetje financiare për komunat për mbulimin e borxheve, dhe atë me vlerë prej 3.032.383.086,00 denarë, gjegjësisht 51% nga vlera e përgjithshme e paraqitur nga komunat dhe njësitë shfrytëzuese.

Borxhlinjtë më të mëdhenj janë:

- ▶ Komuna e Ohrit 971.132.394,00 denarë
- ▶ Komuna e Tetovës 918.811.611,00 denarë
- ▶ Komuna e Karposhit 486.927.773,00 denarë
- ▶ Komuna e Manastirit 307.830.474,00 denarë
- ▶ Komuna e Strugës 262.203.073,00 denarë
- ▶ Komuna e Kumanovës 233.130.023,00 denarë



- ▶ Komuna e Kërçovës 146.371.050,00 denarë
- ▶ Komuna e Gazi Babës 140.344.585,00 denarë
- ▶ Komuna e Çairit 138.505.129,00 denarë
- ▶ Komuna e Kisella Vodës 127.027.735,00 denarë

Vlera e borxhit të komunave, i cili zvarritet në mënyrë të vazhdueshme, e imponon pyetjen për mundësitë që komunat të jenë financiarisht të vet qëndrueshme, në vend të presin mbështetje nga Qeveria për mbulimin e borxheve të krijuara.

3. Rekomandime për menaxhim me financat komunale

- ▶ Gjatë planifikimit dhe përpilimit të buxhetit të komunave të merren parasysh qëllimet strategjike dhe nevojat e komunës.
- ▶ Planifikimi shumëvjeçar i buxheteve prej para do kohe është praktikë e buxhetit qendror, por duhet të bazohet edhe në planifikimin e buxheteve të komunave.
- ▶ Sistemi i planifikimit financiar duhet të jetë real, duke marrë parasysh kapacitetet dhe mundësitë, me qëllim të arritjes së një shkalle më të lartë të realizimit të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara buxhetore.
- ▶ Qytetarët dhe grupet e ndryshme të palëve të interesuara të përfshihen në procesin e përpilimit të buxhetit, duke u mundësuar kohë të mjaftueshme për rishikim, analizë dhe dhënien e komenteve dhe sugjerimeve për përmirësimin e propozim buxhetit.
- ▶ Këshilltarët të kenë kohë të mjaftueshme që ta rishikojnë propozim buxhetin para se të miratohet në mbledhje të Këshillit të komunës.
- ▶ Raportet financiare të cilat e prezantojnë ekzekutimin e buxhetit duhet të jenë publike në ueb faqen e komunës.
- ▶ Furnizimet publike të komunave duhet t'i respektojnë parimet e transparencës, jo diskriminimit dhe trajtimit të barabartë.
- ▶ Të publikohen informata për zbatimin e furnizimeve publike nga ana e komunave në ueb faqet e tyre, veçanërisht në pjesën e parashtrimit të raporteve për zbatimin e kontratave të lidhura për furnizime publike.
- ▶ Komunitat të sigurojnë kapacitete dhe resurse adekuate për menaxhim financiar, duke marrë parasysh madhësinë e komunave dhe numrin e furnizimeve publike që i realizojnë.
- ▶ Komunitat të ndajnë më shumë mjete për mbështetje dhe bashkëpunim me sektorin civil, të cilat do të ndahen në mënyrë transparente, në pajtim me procedurat e caktuara.
- ▶ Komunitat të përpilojnë buxhet qytetar, për prezantim më të thjeshtë dhe të kuptueshëm të mjeteve të planifikuara dhe të realizuara buxhetore për qytetarët.



SHTOJCA 1 – Organizatat partnere - rigrantistë

Shoqata Lëvizja për zhvillim socio-ekonomik
Global Manastir




Shoqata e qytetarëve Qendra për edukim
dhe zhvillim – Tearcë



Shoqata Qendra për iniciativë qytetare Prilep



Qendra e bashkësisë së
Komunës së Strugës



Shoqata Federalistët e rinj evropian – Maqedoni
(XHEF Maqedoni)



Shoqata Nap drejt Evropës Kavadar



Shoqata multietnike dhe joqeveritare "Linda"
Kumanovë



Njësitë skaut "Dimitar Vllahov" Veles



Shoqata NOVUS Strumicë



Shoqata "Iniciativa e intelektualëve të
papunësuar" Vinicë



SHQ Shoqatë ekologjike Planetum – Strumicë



Eho Organizata
edukative-humanitare - Shtip



Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të
bashkësisë – Dibër



Shoqata Drita AGV Gostivar



SHTOJCA 2 – Lista e komunave të cilat u janë përgjigjur kërkesës për qasje të lirë deri te infomatat me karakter publik

Fusha – Transparenca dhe llogaridhënia			
Aerodrom	Debarcë	Krivogashtan	Radovish
Berovë	Dellçevë	Krushevë	Rankovc
Manastir	Demir Kapi	Kumanovë	Resnjë
Bogdanci	Demir Hisar	Likovë	Rosoman
Bosillovë	Dojran	Llozovë	Sveti Nikole
Bërvenicë	Dollnen	Makedonska Kamenicë	Sopishtë
Butel	Gjorçe Petrov	Mogillë	Nagoriçan i Vjetër
Vallandovë	Zërnovc	Negotinë	Strugë
Vasilevë	Jegunovc	Novaci	Strumicë
Vevçan	Kavadar	Novo Sellë	Tearcë
Veles	Karbinc	Ohër	Qendër
Vinicë	Karposh	Petrovec	Qendra Zhupë
Gazi Babë	Kërçovë	Pehçevë	Çashkë
Gjevgjeli	Konçe	Pllasnicë	Çeshinovë-Obleshevë
Gradsko	Koçanë	Prilep	Shtip
Dibër	Kriva Pallankë	Probishtip	Shuro Orizarë

Fusha – Menaxhimi me financat komunale		
Berovë	Karbinc	Resnjë
Manastir	Kërçovë	Rosoman
Bogdanci	Koçanë	Nagoriçan i Vjetër
Bërvenicë	Konçe	Sveti Nikole
Vallandovë	Kriva Pallankë	Strugë
Vasilevë	Krivogashtan	Strumicë
Vevçan	Krushevë	Qendra Zhupë
Veles	Kumanovë	Çashkë
Vinicë	Likovë	Çeshinovë-Obleshevë
Gjevgjeli	Makedonska Kamenicë	Shtip
Gradsko	Mogillë	Aerodrom
Dibër	Novaci	Butel
Debarcë	Ohër	Gazi Babë
Dellçevë	Pehçevë	Gjorçe Petrov
Demir Hisar	Pllasnicë	Karposh
Dojran	Prilep	Qendër
Dollnen	Probishtip	Shuro Orizarë
Zërnovc	Radovish	Qyteti i Shkupit
Jegunovc	Rankovc	



SHTOJCA 3 – Lista e indikatorëve për ueb transparencë

Nr. Re.	Informata	E publikuar		
		Po	Pjesërisht	Jo
1	Statuti i komunës	59%	1%	39%
2	Buletinet zyrtar	63%	12%	25%
3	Informatat për anëtarët e Këshillit me kontakte	44%	40%	16%
4	Informatat për mbledhjet e Këshillit (rendi i ditës, procesverbalet dhe vendimet)	19%	31%	50%
5	Regullorja për punë e Këshillit	35%	0%	65%
6	Komisionet e Këshillit	45%	1%	53%
7	Administrata – organizimi dhe kontaktet	41%	31%	28%
8	Sistematizimi i vendeve të punës	35%	3%	63%
9	Person përgjegjës për qasje më të lehtë dhe mbështetje të personave me aftësi të kufizuara (me kontakte)	22%	1%	77%
10	Person zyrtar për ndërmjetësim me informatat me karakter publik	52%	4%	44%
11	Lista e informatave me karakter publik	47%	5%	48%
12	Propozim buxheti	20%	1%	79%
13	Buxhet i miratuar	74%	7%	19%
14	Buxhet qytetar	3%	0%	97%
15	Llogaria përfundimtare	76%	1%	23%
16	Raporte tremujore dhe vjetore financiare	24%	15%	61%
17	Raporte programore financiare	8%	3%	89%
18	Plani për furnizime publike	34%	0%	66%
19	Raport për realizimin e furnizimeve publike	4%	3%	93%
20	Raport i Entit shtetëror për auditim	16%	3%	81%
21	Ndërmarrjet publike (link, kontakt, qëllimet e shërbimeve)	23%	43%	35%
22	Raporte financiare të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike	20%	20%	60%
23	Prona e patundshme në pronësi të komunës	4%	0%	96%
24	Prona e tundshme në pronësi të komunës	4%	0%	96%
25	Regjistri i organizatave qytetare	16%	3%	81%
26	Informata për financimin e organizatave qytetare	15%	5%	80%
27	Informata për bashkësitë urbane dhe rurale	33%	3%	64%
28	Propozim dokumentet planore	7%	7%	87%
29	Dokumentet planore të miratuara	21%	8%	71%
30	Lista e shërbimeve të cilat i siguron komuna	27%	19%	55%
31	Formularët për shërbime	39%	20%	41%
32	Udhëzime për sigurimin e shërbimeve	20%	13%	67%
33	Strategjia/Programi për zhvillim ekonomik lokal	32%	0%	68%
34	Lista e veprimtarive tregtare me vëllim të vogël	9%	7%	84%
35	Lista e veprimtarive hotelierie me vëllim të vogël	12%	5%	83%
36	Lista e veprimtarive turistike me vëllim të vogël	13%	8%	79%
37	Lista e shërbimeve në turizmin fshatar, etno dhe ekologjik	11%	1%	88%
38	Zonat industriale në territorin e komunës	11%	1%	88%
39	Struktura e fuqisë së punës në komuna	5%	8%	87%

40	Strategjia/Programi për mjedisin jetësor	24%	4%	72%
41	Shkalla e prodhimit të mbeturinave	1%	1%	97%
42	Substanca ndotëse	3%	3%	95%
43	Kadastra e mjedisit jetësor	3%	0%	97%
44	Ndotësit	1%	0%	99%
45	Lejet e lëshuara të integruara ekologjike-B	16%	1%	83%
46	Kadastra e krijuesve të zhurmës	0%	0%	100%
47	Kadastra e krijuesve të mbeturinave	1%	0%	99%
48	Qendrat grumbulluese për pajisje elektrike dhe elektronike	1%	0%	99%
49	Transportuesit dhe automjetet e regjistruara për kryerjen transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor	4%	4%	92%
50	Tregjet në territorin e komunës	1%	4%	95%
51	Deponitë në territorin e komunës	3%	1%	96%
52	Parkingjet në territorin e komunës	3%	3%	95%
53	Raportet tremujore për mbikëqyrjen e kryer të inspektimit	3%	0%	97%
54	Licencat e lëshuara për largimin e automjeteve të dëmtuara dhe automjeteve me defekt	1%	0%	99%
55	Strategjia/Programi për kulturë	19%	0%	81%
56	Monumentet përkujtimore në territorin e komunës	31%	4%	65%
57	Evidenca dhe dokumentacioni i muzeut	4%	4%	92%
58	Objekte nga fusha e kulturës në territorin e komunës (lokale dhe kombëtare)	33%	7%	60%
59	Programi për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të theksuara me shënim përkujtimor	8%	1%	91%
60	Strategjia/Programi për arsim	15%	3%	83%
61	Shkollat fillore në komunë (publike dhe private)	60%	4%	36%
62	Shkollat e mesme (komunale, shtetërore dhe private)	45%	3%	52%
63	Numri i shfrytëzuesve dhe lloji i ndihmës sociale nga buxheti i komunës	1%	0%	99%
64	Institucionet për mbrojtje sociale të kategorive të ndryshme të qytetarëve	3%	1%	96%
65	Objektet sportive në territorin e komunës	27%	4%	69%
66	Pasqyrë e rrugëve me numra të objekteve	4%	4%	92%
67	Propozim planet urbanistike në territorin e komunës (PUQ dhe PUD)	16%	8%	76%
68	Planet e miratuara urbanistike në territorin e komunës (PUQ dhe PUD)	31%	12%	57%
69	Raport vjetor për lejet e lëshuara për ndërtim	3%	1%	96%
70	Shfrytëzimi i tokës për ndërtim për shkak të zbatimit të procedurave për koncesion ose partneritet publiko-privat	0%	3%	97%
71	Kërkesat e parashtruara për legalizim dhe objektet e legalizuara	1%	1%	97%
72	Objekte me certifikata për karakteristika energjetike	0%	0%	100%
73	Çerdhe për fëmijë (publike dhe private) në territorin e komunës	36%	9%	55%
74	Shtëpitë për pleq (publike dhe private) në territorin e komunës	1%	5%	93%
75	Institucionet publike të themeluara nga komuna me qasje për personat me aftësi të kufizuara	7%	1%	92%
76	Projekte të komunës (të realizuara dhe në faza të realizimit)	29%	27%	44%
77	Të dhëna të hapura	0%	0%	100%
78	On-line vegla për komunikim / konsultime me qytetarët	20%	7%	73%



SHTOJCA 4 – Lista e renditjes së komunave sipas barometrit për ueb transparencë

1	Штип	61,54%	42	Демир Капија	19,87%
2	Битола	54,49%	43	Карпош	19,23%
3	Кавадарци	50,64%	44	Центар	19,23%
4	Велес	44,87%	45	Конче	18,59%
5	Охрид	42,31%	46	Јегуновце	17,31%
6	Струмица	42,31%	47	Гостивар	16,67%
7	Радовиш	41,67%	48	Лозово	15,38%
8	Кочани	40,38%	49	Пехчево	15,38%
9	Крива Паланка	38,46%	50	Македонска Каменица	15,38%
10	Василево	37,18%	51	Вевчани	14,74%
11	Гевгелија	37,18%	52	Кривогаштани	14,74%
12	Прилеп	37,18%	53	Сарај	14,74%
13	Богданци	35,26%	54	Дојран	12,82%
14	Делчево	33,97%	55	Ново Село	12,18%
15	Кичево	33,33%	56	Македонски Брод	11,54%
16	Берово	32,69%	57	Валандово	10,90%
17	Демир Хисар	32,69%	58	Дебарца	10,90%
18	Куманово	32,69%	59	Пласница	9,62%
19	Тетово	31,41%	60	Карбинци	8,33%
20	Зрновци	30,13%	61	Желино	8,33%
21	Гази Баба	30,13%	62	Липково	7,05%
22	Ресен	29,49%	63	Сопиште	7,05%
23	Новаци	28,85%	64	Арачиново	5,13%
24	Чашка	28,85%	65	Градско	5,13%
25	Град Скопје	28,85%	66	Могила	5,13%
26	Виница	27,56%	67	Теарце	5,13%
27	Неготино	27,56%	68	Чаир	5,13%
28	Свети Николе	26,28%	69	Росоман	3,85%
29	Ѓорче Петров	25,64%	70	Чучер Сандево	3,85%
30	Дебар	25,64%	71	Студеничани	3,21%
31	Илинден	25,00%	72	Центар Жупа	2,56%
32	Крушево	25,00%	73	Шуто Оризари	2,56%
33	Кисела Вода	25,00%	74	Петровец	1,92%
34	Кратово	23,08%	75	Зелениково	1,28%
35	Долнени	23,08%	76	Боговиње	0,00%
36	Аеродром	21,79%	77	Бутел	0,00%
37	Пробиштип	21,15%	78	Брвеница	0,00%
38	Струга	21,15%	79	Врапчиште	0,00%
39	Чешиново-Облешево	20,51%	80	Ранковце	0,00%
40	Босилово	19,87%	81	Старо Нагоричане	0,00%
41	Маврово Ростуше	19,87%			

 <p>ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ПРОМЕНИ</p>	 <p>Macedonia M·C·A 2000 Management Consulting Association</p>	 <p>SCOOP CIJ-MACEDONIA</p>
<p>Qendra për menaxhim me ndryshime rr. Rajko Zhinzifov nr. 44-1, Shkup tel.: +389 (0) 2 6092-216 e-posta: info@cup.org.mk ueb: www.cup.org.mk</p>	<p>Asociacioni për menaxhment konsulencë MKA 2000 rr. Nikolla Vapcarov nr. 2 kati 5, Shkup tel.: +389 (0) 2 3217-446 e-posta: mca2000info@gmail.com ueb: www.mca-2000.org</p>	<p>Qendra për gazetari hulumtuese SKUP rr. "11 Oktomvri" nr. 2/5-4, Shkup tel.: +389 (0) 2 3113-721 e-posta: info@scoop.mk ueb: www.scoop.mk</p>

